

VENDIM
Nr. 192, datë 27.3.2024

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT “PËR ZBATIMIN E MËNYRAVE
ALTERNATIVE TË PAGESËS SË SHPEJTË” DHE TË PROCEDURAVE PËR
ZBATIMIN E TIJ**

(Ndryshuar me VKM-në nr.473, datë 17.7.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, shkronja “ç”, dhe 9/1, të ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *start up*-eve”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit pilot “Për zbatimin e mënyrave alternative të pagesës së shpejtë”, me qëllim promovimin e konkurrencës, rritjen e produkteve dhe të shërbimeve në tregun financiar, rritjen e inovacionit në sektorin financiar, si dhe përfshirjen financiare të qytetarëve.

2. Numri i përfituesve në kuadër të këtij projekti është 300 (treqind) persona. Vlera monetare për çdo person është 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, të destinuara për shpenzim vetjak. *Vlera monetare disbursohet nga Agjencia Shtetërore për Mbështetjen e Startup-ve dhe Lehtësuesve (“Startup Albania”) në formën e një transferte bankare, brenda datës 30 të çdo muaji, në periudhën kohore korrik deri në tetor 2024, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.* Përfituesit nënshkruajnë deklaratën për dhënien e dakordësisë për pjesëmarrjen në projektin pilot, sipas aneksit A, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Projekti pilot zbatohet në bashkitë Tiranë (njësia administrative 5), Dibër dhe Përmet, për vitin 2024.

4. Përfituesi përdor vlerën e transferuar vetëm nëpërmjet aplikacioneve, që mundësojnë pagesat e shpejta, sipas parashikimeve të këtij vendimi, të përzgjedhur nga ai vetë, bazuar në listën e vënë në dispozicion nga Agjencia Shtetërore për Mbështetjen e *Start up*-ve dhe Lehtësuesve (“*Start up Albania*”). Çdo formë tjetër e përdorimit në kundërshtim me parashikimet këtij vendimi passjell detyrimin për kthimin e shumës së përfituar.

5. *Bazuar në parimin e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit, Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve (“Startup Albania”) dhe bashkitë, në të cilat do të zbatohet projekti, lidhin një marrëveshje për mënyrën e përzgjedhjes së përfituesve të bashkitë përkatëse. Përzgjedhja duhet të jetë e tillë që të garantojë përbërje të drejtë midis moshës, që përfshin përkatësisht përfitues nga grup-moshat 18–30 vjeç, 30–40 vjeç, 40–50 vjeç, 50–60 vjeç, si dhe 60–70 vjeç, dhe gjinisë së tyre, që banojnë brenda një hapësire gjeografike të afërt brenda territorit të bashkive Tiranë, Dibër e Përmet. Bashkitë përzgjedhin përfituesit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas lidhjes së marrëveshjes. Numri i përfituesve për secilën bashki është 100. Lista emërore me të dhënat e përfituesve për çdo bashki dërgohet pranë Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve (“Startup Albania”).*

6. Fondi financiar në vlerën 12 400 000 (dymbëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë për mbulimin e shpenzimeve për përfituesit përdoret nga Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start up*-eve dhe Lehtësuesve (“*Start up Albania*”) vetëm për qëllime dhe në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

7. Subjektet e tregtisë me pakicë, pjesë e këtij projekti, përzgjidhen në raport të drejtë me afërsinë gjeografike të vendndodhjes së përfituesve brenda territorit të bashkive Tiranë, Dibër dhe Përmet.

Përzgjedhja e përfituesve kryhet nga Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start up*-eve dhe Lehtësuesve ("*Start up Albania*") në mënyrë rastësore e transparente, duke pasur parasysh kufijtë gjeografikë të përfituesve të përzgjedhur, sipas pikës 5 të këtij vendimi.

8. Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start up*-eve dhe Lehtësuesve ("*Start up Albania*") përzgjedh, sipas një procedure të hapur e transparente, institucionet e parasë elektronike dhe institucionet financiare, që paraqesin zgjidhje teknike të përshtatshme për zbatimin e këtij projekti, sipas parashikimeve të këtij vendimi. Procedura përzgjedhëse kryhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

9. Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start up*-eve dhe Lehtësuesve ("*Start up Albania*") monitoron procesin e zbatimit të projektit pilot dhe i raporton ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit për ecurinë dhe gjetjet.

10. Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit miraton, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, rregulla të detajuara lidhur me zbatimin e procedurës, përzgjedhjen e subjekteve të tregtisë me pakicë, që operojnë sipas legjislacionit në fuqi, metodologjinë e mbledhjes së të dhënave nga pilotimi, modalitetin e pagesës nëpërmjet portofolit elektronik, që do të zbatojnë institucionet e parasë elektronike dhe institucionet e tjera financiare.

11. Kryerja dhe konfirmimi i pagesës në kohë reale nëpërmjet portofolit elektronik, që ofrojnë institucionet e parasë elektronike dhe institucionet e tjera financiare, realizohet nëpërmjet përdorimit të kodit QR të faturës së fiskalizuar, sipas një procedure teknike. Çdo faturë e gjeneruar nga sistemi shoqërohet vetëm me një kod QR të faturës së fiskalizuar dhe përmban informacion për llogaritë bankare të shitësit, si dhe detajet e faturës. Nëpërmjet një aplikacioni bankar të përzgjedhur nga blerësi, skanohet kodi QR dhe në aplikacion shfaqen të dhënat e faturës e të llogarisë së shitësit. Në çdo rast, blerësit do t'i shfaqet edhe vlera e saktë e kryerjes së këtij transaksioni. Me përzgjedhjen e njëres prej llogarive të biznesit, blerësi konfirmon pagesën, duke përdorur opsionin përkatës. Pas kryerjes së pagesës, nëpërmjet kanaleve bankare të ndërveprimit, konfirmimi i pagesës do të vijë nga banka pritëse. Me marrjen e konfirmimit nga banka pritëse, *e-Albania* informon sistemin elektronik të tatimeve. Sistemi i tatimeve e konsideron këtë faturë të përfunduar dhe nuk lejon që të kryhet pagesë tjetër për këtë faturë, me qëllim shmangien edhe të gabimeve teknike.

12. Ngarkohen ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Start up*-eve dhe Lehtësuesve ("*Start up Albania*"), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe *bashkitë Tiranë (Njësia Administrative 5), Dibër e Përmet* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

ANEKSI A

DEKLARATË

PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR PJESËMARRJEN NË PROJEKTIN PILOT "PËR ZBATIMIN E MËNYRAVE ALTERNATIVE TË PAGESËS SË SHPEJTË"

TË DHËNAT IDENTIFIKUESE

Unë, i/e nënshkruari/a _____, i biri/e bija e _____ dhe
i/e _____, i/e datëlindjes _____, lindur në
_____, banues/e në adresën _____, dhe me numër

kontakti _____, adresë *e-mail*-i _____ me numër personal (sipas letërnjoftimit) _____;

TË DHËNA PËR STATUSIN E PUNËSIMIT

Në punë:

Student:

Pa punë:

Tjetër (specifiko):

TË DHËNAT E LLOGARISË BANKARE NË LEK:

Banka:

IBAN:

KODI *SWIFT*:

ME VULLNETIN TIM TË LIRË DEKLAROJ:

Unë kuptoj dhe pranoj kushtet dhe kriteret për përfitimin e vlerës monetare prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh në muaj, të destinuara për shpenzim vetjak, *për periudhën korrik, gusht, shtator, tetor 2024*, që transferohet në llogarinë time bankare për qëllime të zbatimit të projektit pilot “Për zbatimin e mënyrave alternative të pagesës së shpejtë”.

Unë kuptoj dhe pranoj që fondi i përfituar përdoret **vetëm** nëpërmjet aplikacioneve që mundësojnë pagesat e shpejta, të përzgjedhur nga unë, sipas listës së vënë në dispozicion nga Agjencia Shtetërore për Mbështetjen e *Start up*-ve dhe Lehtësuesve (“*Start up Albania*”) dhe që çdo formë tjetër e përdorimit në kundërshtim me parashikimet e kësaj deklarate passjell detyrimin për kthimin e shumës së përfituar.

Jap pëlqimin se të dhënat e mia personale të deklaruara në këtë deklaratë të trajtohen nga personat përgjegjës për trajtimin e të dhënave personale për qëllime të ligjshme, sipas parashikimeve të legjislacionit të fuqi.

Emri Mbiemri

Nënshkrimi